

PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË MBLEDHJES

KËSHILLI I INVESTIMEVE (KI)

MBLEDHJA XXI

“Për Rimëkëmbjen e Ekonomisë, Post-COVID-19”

Tiranë, 5 qershor 2020, 11:00 – 13:00

Mbledhja u mbajt në formën e një video-konference dhe u drejtua nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Znj. Anila Denaj (Kryetare e KI). Në mbledhje morën pjesë të shtatëmbëdhjetë anëtarët e KI (pjesëmarrje e plotë) dhe rreth 30 vëzhgues – përfaqësues të shoqatave të biznesit vendas dhe të huaj dhe institucioneve shtetërore si edhe përfaqësues të Agjencive të Huaja në Shqipëri.

I. Hapja e Mbledhjes nga Ministria Anila Denaj, Kryetare e KI

Në hapje të Mbledhjes së Këshillit të Investimeve, Ministria Anila Denaj bëri një pasqyrë të situatës së përgjithshme makroekonomike të Shqipërisë, por edhe në kuadrin rajonal e ndërkombëtar. Në kuadër të rimëkëmbjes së ekonomisë gjatë fazës post Covid-19, Këshillit të Investimeve i është kërkuar që të mbështesë me marrjen e të gjitha propozimeve nga bizneset, që funksionojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë shqiptare, në mënyrë që Plani i Rimëkëmbjes të përfshijë përpara prezantimit të tij dhe disa nga këto propozime.

Përsa i përket politikave të zhvillimit ekonomik, zonja Denaj tha se me rëndësi janë stimujt e zhvillimit të sipërmarrjes, jo vetëm fiskalë, por edhe ato të politikave të zhvillimit ekonomik me fokus SME-të. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka propozuar dhe politika të cilat mund të nxisin në të ardhmen investime “smart” në kombinim të skemave jo vetëm të garancisë, por edhe granteve.

Gjithashtu Ministria Denaj vlerësoi politikat e punësimit për të risjellë në tregun e punës atë pjesë të popullsisë që u ballafaqua me humbjen e një marrëdhënie kontraktuale pune. Në të njëjtën kohë, Ministria vlerësoi si shumë të rëndësishëm formalizimin e tregut të punës me një skemë të re që do të mundësonte uljen e informalitetit.

II. Prezantim i Sekretariatit të Këshillit të Investimeve mbi Gjetjet dhe Rekomandimet

Znj. Diana Leka, Sekretariati i KI, dha një prezantim të shkurtër mbi gjetjet dhe rekomandimet kryesore të përgatitura nga Sekretariati i KI. Znj. Leka informoi në lidhje me organizimin e grupeve të punës në energji dhe dixhitalizim, ku theksoi bashkëpunimin me zv/ministren e MBZHR dhe zv/ministren e MIE si dhe me kabinetin e MFE në drejtim të dakordimit të rekomandimeve. Ndërsa në lidhje me grupin e punës për sektorin e energjisë, puna është ende në proces dhe më shumë informacion do të jepet në vijim.

III. Përmbledhje e Komenteve Kryesore të Mbledhjes

Znj. Ines Muçostepa, UCCIAL, shprehu nevojën e dialogut në mënyrë që paketa e tretë të ofrojë zgjidhjet e duhura, por gjithashtu edhe për të mos patur zvarritje për rishikime të kësaj pakete.

- Biznesi ka vërejtje për sa i përket garancive sovrane. Nevojitet shpejtësi për ofrimin e ndihmës për biznesin pasi aktualisht ka zvarritje.
- Hapja e kufijve tokësorë është një iniciativë e cila do të ndihmojë sektorin e turizmit. Sugjerohet një bashkëpunim rajonal me vendet fqinje dhe të bëhet një politikë e përbashkët në mënyrë që të shfrytëzohet sa më mirë momenti.
- Sektori i turizmit ka propozime që shtyrja e kredive të mos jetë 3-mujore, por nga 1 deri 2 vite. Pra të bëhet një strategji e mirëfilltë për shtyrjen e kredive në mënyrë që të mos quhen kredi të këqija.
- Një lehtësi e mirë fiskale për turizmin është ajo e lidhur me TVSH-në. Shumë vende në rajon e kanë hequr TVSH-në për turizmin (si një masë provizore, me vendosjen e një kufiri). TVSH-ja për sektorin e turizmit është goxha e ulët dhe mund të reduktohet deri në 0%, apo edhe restorante që operojnë në turizëm mund të kenë ulje prej 50%.
- Nevojitet një fushatë e përbashkët sensibilizimi për të konsumuar produkte shqiptare. Sektori i bujqësisë apo agro-përpunimit mund të ndihmohet më tej në teknologjisë me anë të granteve apo subvencioneve për ato sektorë që mund të rrisin vlerën e produkteve “Made in Albania”.

Z. Nikolin Jaka, DHTI TR, u shpreh se vendi vazhdon të mbetet në gjendje emergjente, duke ngritur problematikat më kryesore sipas tij për sipërmarrjen:

- Mungesa e likuiditetit dhe ngarkesat fiskale. Ende nuk ekziston një paketë e plotë e cila të bëjë të mundur likuiditetin për biznesin dhe të mundësojë lehtësira fiskale për kushtet e vështira. Ka biznese të cilave iu është miratuar aplikimi për kredi por kontrata ka mbetur e panënshkruar, pasi sistemi bankar nxjerr teknikalitete që e bëjnë të pamundur marrjen e kredisë. Nuk mund të jetë administratori apo aksioneri i kompanisë dorëzanës për një financim ku merret garancia sovrane.
- Nuk ka fleksibilitet dhe shpejtësi në veprim në marrjen e kredive (lidhur me paketen e parë). Informacion më i detajuar pritet për paketë e dytë, e cila është njoftuar se ka një interes prej 5.2 (i cili është tavan).
- Në lidhje me sektorin e turizmit, duhet bashkëpunuar me Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut për hapjen e transportit të udhëtarëve.
- Sektoret prioritarë kanë potencial por konkurrohen nga të gjitha vendet e rajonit.

Në diskutimin e kësaj mbledhje, duhej të ishte përfshirë edhe Ministria e Rindërtimit, z. Arben Ahmetaj, pasi pavarësisht se jepen komente nga biznesi, paketat duket se janë të pakonsultuara. MFE duhet të ruajë një rol vendimtar në paketën e ardhshme.

Z. Enio Jao, AmCham, u shpreh se rekomandimet e KI janë të shumëllojshme, por duhet bërë një diferencim midis atyre rekomandimeve që janë themeltare për përmirësimin e klimës së investimeve. Rekomandimet e tjera jo themeltare (me karakter specifik) duhet të shpërndahen përkatësisht tek institucionet e duhura. Ka ardhur koha që rekomandimet e KI të jenë më efektive në lidhje me zbatueshmërinë dhe impaktin që duhet të arrijnë.

Sipas AmCham, rekomandime themeltare (me prioritet të lartë) janë:

- a) Çështja e monopolit dhe konkurrencës së pandershme;
- b) Lufta kundër korrupsionit;
- c) Përmirësimi i Ligjit të Prokurimeve Publike (përafrimi me legjislacionin e BE-së do të sillte reduktim të korrupsionit);

d) Taksat dhe incentivat për investimet.

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka bërë hapa prapa në lidhje me klimën e biznesit.

Z. Ardian Lekaj, Dhoma e Biznesit të Diasporës, sugjeroi dy masa afatshkurtra: i) për sektorin e bujqësisë: blerjen e stokeve dhe produkteve bujqësore (aplikuar në periudha krizash edhe në perëndim), ii) për sektorin e turizmit: përdorimin e tollonave për pushime verore për familjet në nevojë. Të punohet me hapa të vegjël dhe t'i shkohet deri në fund gjërave.

Znj. Mimoza Emanuels, SAM Wear, nënvizoi nevojën për mbështetjen e sektorit të veshjeve me material porositës dhe me material të gatshëm nga ana e qeverisë, si një sektor strategjik për ekonominë.

- Nevojitet garanci për pagesat e eksporteve për sektorin.
- Të konsiderohet blerja e stokeve të krijuara nëpër magazinat e kompanive nga ana e shtetit për ushtrinë apo policinë për ato artikuj që mund t'i shërbejnë atyre.
- Krijimi i kushteve për mbajtjen e punonjësve në bashkëpunim me punëdhënësit - deri tani është bërë nga shtetit drejtpërdrejt me punëmarrësit.

Ministria Anila Denaj, MFE, sqaroi se diskutimi mbi garancinë e eksporteve është diskutuar edhe më herët me përfaqësues të sektorit të veshjeve, jo në frymë të planit të rimëkëmbjes. MFE është mirëinformuar në lidhje me kërkesat e sektorit në lidhje me këtë çështje. Çështja është diskutuar edhe me partnerët e huaj dhe duket se zbatimi i skemës mbi garancinë e eksporteve kërkon institucione që për momentin nuk janë. Po punohet për ngritjen e një institucioni të pavaruar edhe nga MFE, për ta mbikëqyrur dhe zbatuar atë sikurse dhe rolin e mundshëm të një banke zhvillimi. Duhet të merren parasysh kapacitetet buxhetore dhe rregullatore ekzistuese dhe faktin që mungojnë disa institucione që hapësira juridike ende nuk i ka krijuar, por që duhet të krijohen në një proces afatmesëm. Në fokus për t'u adresuar në momentin e duhur.

Znj. Edlira Muka, Balfin Group, parashktoi disa komente si më poshtë:

- Të konsiderohet formulimi i një pakete nxitje investimesh, e shoqëruar me incentiva sipas shkallëve të investimit dhe e fokusuar në sektorët strategjikë të cilat janë identifikuar tashtë nga Qeveria. Aktualisht, ekziston një paketë për nxitjen e investimeve e cila nuk është shumë tërheqëse në krahasim me vendet e tjera të zhvilluara të rajonit.
- Sa i takon sektorit minerar dhe atij përpunues, Shqipëria ka shumë burime natyrore të cilat eksportohen pa u përpunuar në Shqipëri. Një rekomandim do të ishte të krijoheshin incentiva për stimulimin e përpunimit të burimeve natyrore në vend duke krijuar punësim dhe investime në këtë sektor.
- Nevoja për strategji të informalitetit është trajtuar disa herë në KI. Nëse do të kishte përpjekje konkrete në këtë drejtim do të ishin të mirëpritura në aspektin afatgjatë, në funksion të konkurrencës së drejtë për të bërë biznes.
- Nevojitet një publikim (nga AIDA apo kanaleve të tjera dixhitale) për të qartësuar strategjinë e investimeve publike - pra një roadmap të qartë të tyre (rrugët, uji, kanalizimet, portet, aeroportet), me afatet se kur do të realizohen nga shteti, në mënyrë që investitorët të paraqesin interesa konkrete për investime në sektorët specifikë.

Z. Artan Xhiani, Confindustria Albania, theksoi se Confindustria i ka paraqitur pikat e saj tek KI, dhe një pjesë e të cilave është reflektuar mirë në material. U ndal në disa gjëra konkrete:

- Duhet të hartohet një politikë më e mirë dhe efikase në drejtim të përdorimit të fondëve publike në afatmesëm dhe afatgjatë me qëllim stimulimin e punësimit të qëndrueshëm.
- Politikat e rimëkëmbjes duhet të kenë parasysh sektorët që kanë qenë më të goditur nga kjo pandemi, si p.sh. sektori i turizmit. Masat për këtë sektor të synonin të paktën zgjatjen e sezonit, duke paraqitur disa paketa stimuluese si p.sh.: rimbursim për çdo pushues që hyn në RSH në mënyrë të arsyeshme p.sh.: 10 apo 20 euro për çdo ditë pushimi.
- Masat emergjente duhet të drejtohen tek stimulimi i konsumit dhe në këtë aspekt do ishte mirë të shikohej mundësia e dhënies së tollonave për kategori konsumatorësh për blerjen e produkteve të konsumit. Produkte shqiptare ose jo kjo është temë diskutimi tjetër në kuadrin e masave proteksioniste që mund të ndërmerreshin.
- Shërbimet elektronike të platformës qeveritare duhet të konsiderojnë në të ardhmen edhe shtetasit e huaj (administratorët e huaj të kompanive në Shqipëri).

Ministria Anila Denaj, MFE, solli si një shembull dixhitalizimi edhe procesin i fiskalizimit që pritet të fillojë në shtator 2020, i cili kërkon edhe optimizimin e firmës dixhitale në përdorim. Në një hap të dytë do të kërkohej që firma dixhitale të përdoret edhe në sektorin bankar, duke mundësuar një sistem të plotë e-billing (faturimi) dhe duke optimizuar të gjitha shërbimet e tjera përfshirë ato bankare.

Z. Spiro Brumbulli, Shoqata e Bankave, vlerësoi masën e shtyrjes në kohë të kësteve të kredive (fillimisht me 3 muaj pastaj me 6 muaj), duke ofruar rreth 150 mln euro likujditet të shtuar në treg dhe kontribut të drejtpërdrejtë tek huamarrësit.

- Duke iu referuar eksperiencës në të dyja garancitë sovraane, zbatimi i të cilave u vonua për shkak të paqartësive, z. Brumbulli i kërkoj Ministres Denaj që t’iu lihet më shumë kohë në dispozicion teknikienëve të shkrumajnë aktet përkatëse (të cilat nuk mund të bëhen brenda 2-3 ditëve).
- Dixhitalizimi është një fushë që po përqafohet edhe nga bankat, nëpërmjet mundësive të pagimit të shërbimeve të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Por, vihen re vonesa dhe për këtë AKSHI duhet të ecë më shpejtë. Për shembull, sektori bankar nuk ka mjete në dispozicion për verifikimin e autenticitetit të certifikatave lëshuar nga ana e-Albania. Kërkohet përgatitja e një programi të qartë me veprime dhe afate se si dixhitalizimi të shkojë përpara. Aq më tepër që nuk kërkohej shpenzime apo investime të konsiderueshme.
- Politika monetare dhe ajo fiskale janë shumë të rëndësishme dhe duhet të ecin paralelisht. Plani i rimëkëmbjes të përfshijë këto elementë dhe sa më shumë përfaqësues nga sektorë të ndryshëm, për të bërë ndryshimet e dubura dhe jo të nxituara. Qëllimi është për të mos bërë arnime në politikën fiskale por ndërhyrje të nevojshme që janë kërkuar prej 20 vitesh. Referencë iu bë deklarates së Kryeministrit në lidhje me ndryshimin themelor të politikës fiskale sa i takon mospagimit të taksave nga biznesi i vogël deri në 2029.
- Sektori bankar është i hapur për më shumë investime në bujqësi dhe është gati për të organizuar takimin në lidhje me financimin e sektorit.

Ministria Anila Denaj, MFE, komentoi politikën fiskale e cila në fokus ka pasur rekomandimet e FMN. Ka lehtësira që duhen vlerësuar më tej pasi nuk janë materializuar në atë output-in që pritej. Puna teknike e MFE e bërë në një kohë rekord nuk duhet transmetuar si mungesë kohe në dispozicion për implementimin e dy garancive bankare. Nëse koncepti i “*risk sharing*” duhet të ndryshojë e ndryshojmë, por kjo nuk do të thotë që t’i referohemi si gabim teknik. Së dyti, nëse norma e interesit në garancinë e parë sovraane me përlllogaritjen tonë teknike duhej të ishte në 2,85 %, qeveria thotë po e subvencionojmë - as ky nuk është gabim, pra në të dyja rastet

është qasja pozitive e qeverisë për t'i krijuar hapësirë teknikëve për atë që mund të jetë optimizimi i garancive. Bankat të fillojnë të mendojnë mbi diversifikimin e mënyrës tradicionale të financimit, të heqin frikën e të gërshetojnë adoptimin e teknologjisë së informacionit me planet e tyre të politikës së riskut, ta zgjerojnë këtë si në raport me bujqësinë me zinxhirët e vlerave e të mos e lënë një garanci bankare katër vite pa u përdorur (nuk është pak 180 mil euro me 40 mil të përdorura në katër vite), duke përdorur garancitë në maksimum. Problematikat kryesore kanë të bëjnë me institucionet, qasjen e politikave dhe gërshetimin e tyre në të njëjtën kohë.

Z. Agim Rrapaj, KASH, u shpreh se në materialin e përgatitur nga Sekretariati janë përfshirë propozimet e sektorit të bujqësisë. Ndër të tjera, z. Rrapaj propozoi:

- Përfshirjen e “Përmirësimi Ligjor” në materialin e përgatitur nga Sekretariati, si pjesë shtesë e tre elementëve të tjerë të përfshirë (Koordinimi dhe Bashkëpunimi, Dixhitalizimi, Financimi);
- Të hiqet “agropërpunimi” dhe të shtohet pjesa e subjekteve prodhuese të furnizimit të popullit me ushqime duke qënë se agropërpunimi është pjesë e saj. Është momenti që zinxhirin ushqimor ta shohim në tërësi duke qënë se fokusimi tek hallka të vecanta nuk na ka dhënë rezultatet që duam. Nëse shtohet edhe përmirësimi ligjor, propozimet e prezantuara në material përbëjnë një paketë mjaft të mirë për subjektet prodhuese të zinxhirit ushqimor.
- Nevojën për dakordësim edhe me ministrat e tjerë të përfshirë në fazën e rimëkëmbjes së ekonomisë, për një ballafaqim të duhur me të gjitha grupet e interesit, gjë që do të shkurtonte afatet e zbatimit.

Ministria Anila Denaj, MFE, informoi pjesëmarrësit mbi Programin e BERZH-it për Mbështetjen e Agrobiznesit (*anglisht: Albania Agribusiness Support Facility-AASF*), i cili po zbatohet që prej vitit 2016 në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare. Së fundmi, me asistencë teknike dhe burimet e MFE është hartuar produkti financiar i këtij programi, që quhet “*Value Chain Finance Concept*” i cili mund të krijojë një sinergji tjetër, jo vetëm të garancisë, por edhe për nevojën që kanë bizneset në fushën e agroindustrisë.

Në këtë kuadër, Ministria Denaj ftoi në një takim Shoqatën e Bankave, BERZH, MBZHR: (1) për të vendosur sesi mund të optimizohet ky instrument në funksion të rekomandimeve të KI apo edhe propozimeve të mëparshme, dhe (2) për të diskutuar nevojën për përmirësimin ligjor të përmendur. Ministria Denaj mori përsipër angazhimin për të realizuar këtë takim me MBZHR brenda javës së ardhshme.

Dr. Constantin Von Alvensleben, FIAA, ngriti disa pika si më poshtë:

- Nevojën për forcimin e sektorit prodhues përmes masave të ndryshme, me ndihmën e ndërkombëtareve, në veçanti të investitorëve të BE-së, si për shembull ndërmarrjeve të mesme nga Gjermania, Austria, Italia dhe vendet e tjera. Shqipëria ka një vendndodhje të shkëlqyer, kosto konkurruese të punës, gjurmë mjedisore shumë më të mira se ato të prodhuara në Lindjen e Largët. Pra, nëse sektori prodhues mund të forcohet këtu, kompanitë e huaja mund të stimulohen për të investuar këtu. Kjo do ta ndihmojë këtë vend të rrisë të ardhurat nga eksportet dhe do të ndihmojë për të mbajtur të rinjtë këtu në vend.
- Arsimi, trajnimi do të duhet të bëhen në vend, në mënyrë që investitori i huaj të gjejë fuqi punëtore të kualifikuar.

- Infrastruktura gjithashtu është shumë e rëndësishme, përfshirë këtu transporti hekurudhor. Në lidhje me projektin hekurudhor Tiranë – Durrës, TIA ka evidentuar një problem me gjetjen e vendndodhjes së saktë të stacionit brenda aeroportit por kjo mund të diskutohet dhe të gjehet një zgjidhje. Lidhje të tjera hekurudhore në Shqipëri do të vlerësohen dhe do të ndihmonin mjaft investitorët e huaj.
- Pezullimi i taksës së kalimit të kufirit (EUR 10 për çdo pasagjer), do të sillte uljen e çmimit të biletës, duke nxitur kështu transportin ajror dhe turizmin.

Z. Archileas Canacaris, Vodafone Albania, u shpreh se Shqipëria nevojitet të përshpejtojë dixhitalizimin nëpërmjet dy elementëve (1) investimeve monetare nga qeveria në infrastrukturë, dhe (2) vënies në fuqi të ligjeve dhe rregullave me 0 kosto.

- Duhet të punohet ngushtë me MIE për të mbështetur përsheptimin e përmirësimit të infrastrukturës së telefonisë fikse. Në infrastrukturën mobile, Shqipëria është përpara, por kriza e bëri të qartë se cilësia e infrastrukturës së telefonisë fikse është shumë larg asaj që duhet të jetë.
- Dixhitalizimi po ndodh dhe kompanitë po virtualizohen, duke ndryshuar mënyrën e ndërveprimit me klientët e tyre. Ekonomitë e tjera po ri-fillojnë, pa u rikthyer në normalitetin e vjetër. Ata po rifillojnë në një mënyrë të re që i lejon të jenë fleksibël në rast të një vale të dytë të mundshme të kësaj krize. Në lidhje me dixhitalizimin e NVM-ve mund të bëhet shumë në lidhje me (1) njohuritë dhe (2) pajisjet teknologjike.
- Mund të bëhet shumë për të thjeshtëzuar ekosistemin dixhital të vendit nëpërmjet thjeshtimit të rregullave krijuar prej shumë kohësh. Në kuadër të shërbimeve qeveritare ofruar nga e-Albania, Vodafone Albania shpreh vullnetin për të ndarë eksperiencën e saj për të bërë të mundur investimin në vendin e duhur. Ende ka një debat rreth ligjit për nënshkrimin dixhital, por nëse kjo çështje zgjidhet, transaksionet do të bëhen më të lira, më të shpejta, më të mira dhe në rast të një vale të dytë të krizave nuk do t'i detyronim klientët tanë të vizitojnë dyqanet për të bërë ndonjë lloj transaksioni. Nënshkrimi dixhital kërkon shumë pak investime por ofron një ndryshim të madh.

Znj. Stephanie Sieg, DIHA, theksoi dy pika: 1) Në sektorin e turizmit oferta mund të zgjerohet si p.sh. në drejtim të sektorit të shëndetësisë në formatin e qendrave të rehabilitimit. Qeveria shqiptare mund të nënshkruajë marrëveshje me ministrinë gjermane që të zhvillojnë sektorin në këtë drejtim, 2) Shqipëria mund të shkurttojë zinxhirët e furnizimit për shtetet e Europës perëndimore. Aktualisht, Gjermania ka një kërkesë të madhe për maska të cilat prodhohen në Azia dhe aktualisht po kërkon kanale të tjera furnizimi më të afërta, ndaj kjo është një mundësi që Shqipëria mund ta shfrytëzojë.

Z. Mario Mariani, Delegacioni i BE-së vlerësoi dokumentin e përgatitur nga Sekretariati i KI në veçanti përsa i përket: 1) përhpjekjes për të formalizuar ekonominë, dhe 2) theksimit për një kuadër ligjor të stabilizuar dhe të thjeshtë për bizneset, më specifikisht në aspektin e kuadrit fiskal. Pavarësisht se janë parashtruar shumë propozime, është e rëndësishme që të mos shkohet në fragmentizime pasi masa specifike për biznese e sektorë specifikë mund të thyenin sistemin në tërësi. Duhet investuar në biznese "smart", të analizohet gjurma mjedisore e këtyre iniciativave dhe të gjenerohen investime e masa strategjike. Duhet të mendohet në terma afatgjatë dhe në impaktin e masave të shpëtimit, në masa të cilat kanë në përmbajtje elementë reformues dhe që ndihmojnë zhvillimin sistematik të vendit dhe ekonomisë. Ekzistojnë disa masa që qeveria mund të ndërmarrë në këtë drejtim, për shembull në rastin kur shqyrton përjashtimet selektive të taksave.

Znj. Maryam Selim, Banka Botërore, u shpreh se materiali i përgatitur nga Sekretariati është i mirëstrukturuar dhe ka propozime mjaft interesante ku veçon propozimin që turizmi të fokusohet në zgjerimin e kërkesës dhe incentivimin e turistëve. Për më tepër, e-commerce dhe shtimi i shërbimeve publike online (e-signature, etj.) janë një domosdoshmëri për të ecur më tej.

Z. Mateo Colangeli, BERZH, u fokusua në disa masa kryesore të cilat mund të kontribuojnë në rimëkëmbjen afat-mesme të ekonomisë.

- Ai theksoi rëndësinë e fokusimit në sektorë që mbështeten mjaft në fuqinë punëtore si turizmi dhe agrobiznesi (të cilat në një farë mase janë të lidhur me njëri-tjetrin) dhe ku vendi ka përparësi të dukshme konkurruese, përmes përmirësimit të cilësisë dhe zgjerimit në segmente tregu ku shpenzohet më shumë.
- Në turizëm për të tërhequr turistë me shpenzime më të larta, duhen bërë përpjekje në 3 drejtime: (i) investime të synuara në infrastrukturë, veçanërisht në atë të transportit, në mënyrë që vizitorët të mund të lëvizin me lehtësi dhe të pavarur në të gjithë vendin; (ii) të ofrohen aktivitete dhe përvoja turistike, duke krijuar vende pune dhe duke rritur të ardhurat mesatare të fituara për turist; (iii) të mbrohen bukuritë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të vendit. Turizmi gjithashtu mund të luante një rol të fortë promovues për produktet shqiptare të agrobiznesit. Aktualisht, BERZH dhe BE po punojnë për një program mbështetje për turizmin, duke shpresuar që partnerët shqiptarë do të jenë gati për ta vënë në zbatimin së shpejti.
- Mbi industrinë përpunuese, kriza e Covid-19 solli me vete një mundësi të madhe për Shqipërinë. Zinxhirët globalë të vlerës së prodhimit po shkurtohen ndërsa prodhuesit evropianë po kërkojnë ofrues të afërt me vendet e tyre, ndaj mund të ketë një mundësi në dy vitet e ardhshme që Shqipëria të hyjë në zinxhirë vlerash, për të cilat nuk ka qenë kurrë pjesë deri më sot. Një strategji për tërheqjen e investimeve dhe promovimi i synuar i vendit drejt shoqatave të industrisë dhe palëve të interesuara përkatëse në vendet kryesore të prodhimit evropian do të ishte një përpjekje e vlefshme, veçanërisht tani kur ka një vrull të vërtetë në përafrimin e Shqipërisë në BE.
- Energjia diellore mund të zhvillohet në Shqipëri me çmime shumë konkurruese dhe se IHD-të cilësore mund të tërhiqen në Shqipëri përmes proceseve tenderuese transparente dhe konkurruese.

Ministrja Anila Denaj, MFE, falenderoi koordinimin e donatorëve mbi kontributin në drejtim të skemave të edukimit profesional kryesisht në fushën e TIK dhe kërkoi që të mundësohet mbështetje në drejtim të formimit profesional në sektorin e turizmit përmes shkollave apo kurseve profesionale në mbështetje të rimëkëmbjes së këtij sektori.

IV. Mbyllja e mbledhjes

Në mbyllje të mbledhjes, Ministria Denaj falenderoi të gjithë pjesëmarrësit dhe theksoi tre pika (1) kalimin e materialit tek komiteti që po punon mbi planin e rimëkëmbjes, (2) diskutimin e mëtejshëm mbi çështjet që mund të kenë nevojë për t'u debatuar më tepër mbi paketat e mbështetjes si p.sh. nxitjen e bankave për ta bërë sa më optimale paketat, (3) njofimin në lidhje me takimin vijues për sektorin e bujqësisë, ku në fokus të diskutohet se si zinxhirët e vlerave mund të kthehen në një produkt të thjeshtë për t'u përthithur nga bizneset dhe për t'u financuar nga bankat.

Lista e pjesëmarrjes

Përfaqësues të qeverisë

1. Znj. Anila Denaj, Kryetare e Këshillit të Investimeve/Ministre e Financave dhe Ekonomisë
2. Z. Aleko Proko, Shef Kabineti, deleguar nga z. Eduard Shalsi, Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
3. Znj. Natasha Ahmetaj, Zëvendës Guvernatore e Bankës së Shqipërisë
4. Znj. Mileva Meksi, Drejtore e Drejtorisë së Investimeve, deleguar nga z. Sokol Nano, Drejtor Ekzekutiv, AIDA
5. Znj. Blerina Turdiu, Drejtor Ekzekutiv, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës

Përfaqësues të biznesit

1. Z. Nikolin Jaka, Kryetar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë
2. Dr. Constantin Von Alvensleben, President, FIAA
3. Znj. Ines Muçostepa, Kryetare e Unionit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë (UCCIAL)
4. Z. Artan Xhiani, Ortak Themelues i Confindustria Albania, deleguar nga Presidenti i Confindustria Albania, z. Sergio Fontana
5. Z. Enio Jaço, Presidenti i AmCham
6. Znj. Stephanie Sieg, Presidente e Dhomës Gjermane të Tregtisë (DIHA)
7. Z. Ardian Lekaj, Përfaqësues Ligjor, Dhoma Shqiptare e Biznesit të Diasporës
8. Z. Archileas Canacaris, CEO, Vodafone Albania (*ad-hoc*)
9. Znj. Mimoza Emanuels, CEO, Samwear (*ad-hoc*)

Partnerë ndërkombëtarë

1. Z. Matteo Colangeli, Drejtor i Zyrës së BERZH-it në Shqipëri
2. Z. Mario Mariani, Shefi i Bashkëpunimit, Delegacioni i BE-së
3. Znj. Maryam Selim, Country Manager, Banka Botërore në Tiranë
4. Znj. Laura Qorlaze, Përfaqësuese e Zyrës së IFC në Shqipëri

Të ftuar të veçantë:

1. Znj. Belinda Ikonimi, Zv/Ministre e Financës dhe Ekonomisë
2. Znj. Ermira Gjeçi, Zv/Ministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
3. Z. Spiro Brumbulli, Sekretar i Përgjithshëm, Shoqata Shqiptare e Bankave
4. Agim Rrapaj, Keshilli I Agrobiznesit Shqiptar
5. Z. Patrik Meier, Zëvendës Shef Misioni, Ambasada e Zvicrës në Shqipëri
6. Z. Simone Ungersboeck, Shef i Zyrës së Koordinimit për Bashkëpunimin Teknik, Ambasada Austriake
7. Z. Brian Williams, Ambasador, UN
8. Znj. Judith Hoffmann, Shefe për Bashkëpunim, Ambasada Gjermane
9. Z. Andrew Maybrook, Specialist i Lartë, USAID/Albania
10. Znj. Jelena McCoy, Shefe e Koordinimit të Programeve, Prania e OSBE në Shqipëri
11. Znj. Sonja Kurz, Drejtore, GIZ Albania
12. Znj. Edlira Muedini, Menaxhere Projekti, RisiAlbania
13. Znj. Edlira Muka, CEO, Balfin Group (*ish anëtare e biznesit pranë Këshillit të Investimeve*)
14. Znj. Linda Legisi, CEO, OMEGA sh.p.k. (*ish anëtare e biznesit pranë Këshillit të Investimeve*)